



**RAPORTET VJETORE TË PUBLIKIMEVE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE PËR
VITIN 2012 DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

PRISHTINË, KORRIK 2013

PËRMBATJA:

HYRJE.....	3
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË AUDITIMIT	3
SHPJEGIMI I TERMAVE DHE SHPREHJEVE	4
QËLLIMI	5
STANDARDED DHE ETIKA	6
PROCEDURAT E KRYERA.....	6
BURIMET E INFORMATAVE	6
TE GJETURAT E PËRGJITHSHME	6
REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME.....	8

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Për: Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor

Rr.Migjeni, p.n, 10000, Prishtinë, Kosovë

HYRJE

Duke ju referuar kërkesës nga Ligjin për financimin e Subjekteve Politike Ligji Nr. 03/L-174 dhe Ligjit Nr.04/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-174, nenit 15 për raportimin financiar, subjektet e regjistruara politike ia dorëzojnë KQZ-ës për çdo vit raportin vjetor financiar më së largu deri me 1 mars të vitit vijues në mënyren e paraparë nga KQZ-ja. Sipas pikes 4 të nenit të lartpërmendur, KQZ-ja duhet të publikoj të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj. Me qëllim të njoftimit të subjekteve politike të audituara, KQZ-ja pas pranimit të raportit final të auditimit ju dorëzon nga një kopje organit më të lartë të subjekteve politike. KQZ-ja po ashtu përgatit një raport vjetor të shpërndarjes dhe shpenzimit të mjeteve nga Fondi për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË AUDITIMIT

Në pajtueshmëri me specifikimet teknike të tenderit dhe kushteve të kontratës të dates 15 Prill 2013, me të cilën jemi pajtuar që ne të kryejmë auditimin e Raportëve vjetore të publikimeve financiare vjetore të subjekteve politike për vitin 2011 dhe 2012 (nr. i prokurimit 320/12/004/221) të cilat duhet të dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor, ju prezentojmë Raportin e Fakteve të Gjetura ("Raporti") bashkë me Raportet Financiare shoqëruese të subjekteve politike për vitin 2011-2012.

Auditimi i Subjekteve Politike është bazuar në raportimin financiar të Subjekteve Politike që është rregulluar me Ligjin për financimin e Subjekteve Politike LIGJI Nr. 03/L-174; Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloret e KQZ-ës01/2008, përkatësisht Rregulloren 12/2009.

SHPJEGIMI I TERMAVE DHE SHPREHJEVE

Për qëllimet e këtij raporti termet dhe shprehjet janë përdorur në kuptimin si vijon:

KQZ- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

SKQZ-Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

SP-Subjekti Politik.

Subjekt Politik - parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur.

Parti politike - çdo parti politike e regjistruar dhe certifikuar nga organi kompetent për regjistrim dhe certifikim.

Kontribut – dhuratat (donacionet) ose cila do ndihmë që i jepet subjektit politik , në para të gatshme apo në të mira material.

Kontributet në natyrë (mall apo shërbime)- mallrat apo shërbimet që i sigurohen subjektit politik pa obligim pagese.

Pagesë - transferi i mjeteve nga subjekti politik per faturen, kontraten, e që lidhet për një furnizim, shërbim apo punë të kryer.

Shpenzim - pranimi i mallrave te blera, shërbimeve apo kryerja e punëve apo edhe pagesa e tyre.

Parimi aktual – te hyrat dhe shpenzimet që i takojnë një periudhe .

Të ardhura- çdo shumë monetare që subjekti politik ka pranuar nga personat fizik apo juridik, kuota e anetarsisë dhe Buxheti i Republikës së Kosovës.

Detyrim- obligim i subjektit politik per nje transakcion te ndodhur.

SNA- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

TMB – Tatimi i mbajtur në Burim.

TVSH – Tatimi i Vlerës së Shtuar

QËLLIMI

Angazhimi jonë ishte një vlerësim i të hyrave dhe shpenzimeve nëse janë në pajtueshmëri me Rregullen e KQZ-së 01/08 dhe Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ky angazhim kërkon të aplikohen Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) për procedurat e rëna dakord për Raportet Financiare në mes të juve (SKQZ) si “Autoritet kontraktues” dhe subjekteve politike. Qëllimi i këtij vlerësimi ishte të plotësojmë (kryejmë) disa procedura për të cilat ne jemi pajtuar dhe në bazë të këtyre procedurave të paraqesim raportin me të gjeturat faktike.

Ne kemi aplikuar principet dhe kriteret kur kemi planifikuar dhe kryer procedurat specifike në vlerësimin e të hyrave dhe shpenzimeve.

Subjektet Politike ne raportimin vjetor financiar kane paraqitur formularet qe permbajne:

- **Bilancin e gjendjes** - bilancin e gjendjes, i cili tregon pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët e para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport.
- **Pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve:** tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj gjatë periudhës së përfshirë në raport.
- **Pasqyrat –shpalosjet:**
 - Llogarite qe merren dhe detyrimet (borxhet e partisë politike)
 - Donacionet dhe kontributet në të holla
 - Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime
 - Donacionet dhe kontributet në të holla nëse vlera e të gjitha kontributeve nga një burim i vetëm i kalon 5000 euro.

Te hyrat per financimin e subjekteve politike jane:

- Te hyrat nga antarsia-kuota e antarsise
- Donacionet dhe kontributet në të holla
- Te hyrat e gjithmbarshme te kontributeve në natyrë në mall dhe shërbime
- Te hyrat nga fondi per financimin e Subjekteve politike - financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

STANDET DHE ETIKA

Angazhimi jonë është ndërmarrë në pajtueshmëri me:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA 920), Standardet Ndërkombëtare për Shërbimet e Lidhura (SNSHL) 4400, Angazhimet me procedura të rëna dakord në lidhje me informacionin financiar siç është i shpallur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK);
- Kodi i Etikës për Kontabilistë Profesional, lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Etikës për Kontabilistë (BNSEK) të FNK-ës. Gjithashtu për SNSHL 4400 pavarësia nuk është kërkesë e angazhimeve të rëna dakord, sidoqoftë Autoriteti Kontraktues kërkon që audituesi të përmbushë kërkesat e pavarësisë sipas Kodit të Etikës për Kontabilistë Profesional.

PROCEDURAT E KRYERA

Ashtu siç është kërkuar ne kemi kryer procedurat e vlerësimit të të hyrave dhe shpenzimeve nëse janë në pajtueshmëri me Rregullen e KQZ-së 01/08 dhe Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit për këtë angazhim.

Këto procedura kanë qenë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues dhe ato janë kryer vetëm që të ndihmojnë Autoritetin Kontraktues në vlerësimin nëse subjektet politike në Raportet Financiare shoqëruese kanë prezentuar të hyrat dhe shpenzimet në përputhje me kërkesat për raportim financiar.

BURIMET E INFORMATAVE

Raporti paraqet informatat e prezentuara nga ju në raportet e dorëzuara në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor si obligim i subjekteve politike për raportim financiar. Po ashtu gjate punes tone kemi marrë parasysh edhe dokumentacionin e subjekteve politike faturat, deftesat, raportet bankare, pagesat, kontratat, evidencat e krijuara nga subjektet politike, kalkulimet e pagave, deklarimet e tatimeve dhe kontributeve, raportimet tremujore, listat e pagave dhe çdo dokument tjetër që eshte konsideruar relevant.

TE GJETURAT E PËRGJITHSHME

Ne gjatë kryerjes së auditimit të raporteve financiare për vitin 2011 dhe 2012 kemi hasur në gjetje të cilat i konsiderojmë të raportueshme prandaj ne forme te pergjithsuar po i permendim disa nga të gjeturat me te theksuara te subjektet politike:

Nuk mbahet kontabilitet i dyfishte, rrjedhimisht nga ana e subjekteve politike nuk pergatiten pasqyrat financiare por raporte financiare.

Mosaplikimi i parimit akrual, te hyrat por edhe shpenzimet duhet te prezentohen ne periudhen te ciles i takojne.

Mosaplikimi i procedurave te prokurimit publik per blerjet (parimi i transparences ne shpenzimin e fondeve publike).

Nuk perdoret ofertimi konkurrues-të njejtit furnitor gjatë dy viteve neper subjekte politike.

Dokumentimi i blerjeve me kupona fiskal, kupona, paragon ose me dokument te krijuar nga subjekti politik.

Blerjet nga Serbia pa paguar doganen ne importimin e mallrave (telefona, kompjutera).

Mosorganizimi dhe mosfunksionimi i kontrollit te brendshem ne subjekte politike.

Pershkrimi i manget ne fatura-nuk pershkruhen sakte artikujt dhe sasia (p.sh gomat e veturave-per çfarë veture? Ose te derivatet nuk ceket cila veture eshte mbushur me derivate).

Mosmbeshtetja e raporteve me shenime-detaje te faturave, kontratave etj.

Te shumica e subjekteve politike personat qe kane mbajtur evidencen nuk jane se paku kontabilist te çertifikuar.

Te disa SP vetem formalisht eshte caktuar perfaqesuesi financiar, praktikisht punen e tij e kryen kryetari i SP.

Nuk ka rregullore për punën e arkës , nuk perpilohet-formohet dokumentacioni per arke dhe per pagesat nga arka.

Përfshirja e shpenzimeve nga viti 2011 në raportet e vitit 2012 si dukuri te subjektet politike (qiraja, rryma, pagat, shpenzime tjera).

Moskalkulimi ne raportet financiare dhe mospagesa e tatimeve dhe kontributeve nga te ardhurat personale dhe mospagesa e tatimit ne qira.

Nuk kane te prezentuar ekzistimin e automjeteve te zeri i aseteve por kane shpenzime te karburanteve.

Subjektet politike te komunitetit serb duhet ti permbahen legjislacionit tatimor te Kosoves rreth elementeve te permbajtura ne faturat tatimore, (numri i regjistrimit te biznesit, numri i veprimtarise, numri fiskal etj).

Fatura tatimore ne emra personal jo te subjektit politik te perfshira ne shpenzime.

Blerja e artikujve (miell nuk shkruan cili tip) dhe shperndarja, por nuk ka regjister as konfirmim te atyre qe e kane pranuar, kurse jane trajtuar si shpenzime.

Mbetjet e mjeteve financiare (parave) ne shuma mjaft te larta ne llogari bankare ne fund te vitit te disa subjekte politike.

Deklarimi vetem i shpenzimeve (pa te hyra) te disa subjekte politike.

Pranimi i raporteve financiare nga disa subjekte politike pas skadimit të afatit (me 13.03.2012).

Pozicioni i te hyrave te shtyera nuk kuptohet nga perfaqesuesit financiar te subjekteve politike.

Pagesat me para te gatshme terheqje nga llogarit bankare ne arke dhe pastaj pagesa me para te gatshme nga arka eshte shfaqur si dukuri për disa subjekte politike gjatë dy viteve.

Subjektet politike nuk mbajn evidence per pasurit (Asetet) sipas kostos historike.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

Me qëllim të evitimit të gabimeve në të ardhmen , avansimit të raportimit financiar, shfrytëzimit më efikas të mjeteve nga Fondi, ne rekomandojmë Menaxhmentin e KQZ-ës që të implementojë rekomandimet si vijojn:

Monitorimi i SP ne shpenzimin e te hyrave sipas kuartaleve dhe vetem pastaj te lejohet transferimi i mjeteve tjera.

Detyrimi i zhvillimit të vazhdueshem profesional i perfaqesuesve financiar te SP.

Detyrimi i SP që të respektojnë nenin 14 te Ligjit për financimin e Subjekteve Politike Ligji Nr. 03/L-174 jo vetëm për caktimin formal të zyrtarit të autorizuar financiar por te punësimit të personit profesionist.

Insistimi ne mbajtjen e kontabilitetit te mirefillte dhe aplikimin e Standardeve te Kontabilitetit.

Kufizimi i pagesave me para te gatshme (cash) ne shumat >se 100.00 E.

Caktimi i maksimumit te arkës dhe detyrimi i perpilimit të rregulloreve për punë të arkës nga ana e SP.

Kushtezimi i pageses se pagave permes llogarive bankare.

Te njoftohen SP se nuk do të pranohen si deshmi te blerjes kuponat fiskal ose kuponat.

Angazhimi i auditimit te jashtem nga ana e SP.

Ndryshimi i formularit- pagesa e kontributit, donacionit nga anetaret e SP te behen ne llogari bankare te SP, e jo ne arke.

Subjektet politike duhet qe ne çdo fund vite te bejne regjistrimin e pasurive dhe te mbajn evidenca dhe ti numerizojn ato.

Subjektet politike duhet qe te shenojn sakt emrin mbiemrin dhe adresen e sakt te kontributdhenesit me qene se kemi hasur ne njerez me mbiemra të njejet.

Ne vazhdim paraqesim ne forme te permbledhur tabelare te hyrat dhe shpenzimet te Subjekteve Politike :

Ky raport lidhet vetëm me Raportet Financiare të përmendura më lartë dhe nuk shtrihet në ndonjë nga pasqyrat tuaja financiare.

Ne ju mirëpresim në diskutimin e Raportit tonë me ju dhe do të jemi të kënaqur të japim ndonjë informatë ose ndihmesë.

Me respekt,

NSH "Etika"

Prishtine, 01 Korrik 2013



Në vijim mund ti gjeni raportet financiare të SP të pranuar në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor me të gjeturat (nëse ka) dhe rekomandimet: